REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PATOS**
**KËSHILLI I BASHKISË**
**KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK**

**Nr.** 2362/18 **Prot.** **Patos, më** 11/09/**2025**

**PROCESVERBALI I TAKIMIT 9 SHTATOR 2025**

**Vendi:** Salla e Këshillit Bashkiak Patos

**Ora e fillimit:** 10:00

**Ora e mbarimit:** 11:00

**Dëgjesë publike me temë: "Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026".**

**Baza Ligjore:** Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026".

**Pjesëmarrës**: Kryetar i bashkisë z. Fation Duro, Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj, Sekretare e KësillitAnëtarë GMS dhe përfaqësues të bashkisë Patos, administrator i njësisë administrative Zharrëz, *rreth 33 pjesëmarrës (banorë, kryetarë të fshatrave, përfaqësues nga bizneset)*

**Takimin hapet nga Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj**

**Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj**- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Kryetar i Këshillit**
**z. Armand Ahmetaj**
**Dëgjesë publike me temë:**
**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**


Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026", jemi këtu sot për të bërë një rishikim të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe për të rishikuar ndyshimet e Paketës Fiskale 2026. Ju ftoj të ndjekim prezantimin e ekzekutivit dhe më pas mund të jepni sugjerimet dhe kërkesat tuaja.

**Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj**– përshëndetje të gjithëve! Jemi këtu për të prezantuar ndryshimet që do të bëhen në paketën



**Drejtor**
**z. Çajup Refitaj**

**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**

**Shtator 2025**

fiskale. Duke bërë një studim në zonë lidhur me pjesën e tarifave ne po shikojmë të gjithë elementët që mund të ndryshojnë duke i parë ato zë më zë duke filluar nga shpenzimet kostante te ato variabël. Ne kemi arritur në konkluzionin që këto tarifa do të ndryshojnë për shkak të kostove që kanë. Po studiojmë që rritja të mos jetë në ato nivele që popullata ta ndjej të papërballueshme këtë rritje. Duke qënë se kemi bërë edhe Planin e Menaxhimit të mbetjeve ne kemi studiuar faktorët e menaxhimit të mbetjeve duke marrë në studim edhe bizneset që gjenerojmë mbetje. Po shikohen variantet e rritjes së këtyre tarifave. Kemi parë dy kategoritë që kemi si aktorë si biznesin ashtu edhe familjen. Te biznesi duke qënë se taksat kanë qënë të pandryshueshme tashmë është parë që ky elementë është në ndryshim të vazhdueshëm në raport edhe me mbetjet e prodhuara. Taksat do të ngelen të pandryshueshme. Taksa e objektit për biznesin është në nivelin 109 L/$m^2$, taksa e truallit 15 L/$m^2$ , taksa e ndikimit në infrastrukturë e me rradhë.Pushteti vendor ka hapësira në lëvizjen e taksave deri në 30% të nivelit. Në vitin e ardhshëm do ngelemi në nivele të njëjta. Për individët taksa e ndërtesës është 15 L/$m^2$, ajo e truallit 0.14 L/$m^2$. Në dëgjesat e mëparshmë ka patur një kërkesë për emigrantët dhe tarifat që ata paguajnë. Po shikohet mundësia, por kemi një vështirësi në përcaktimin e ditëve të qëndrimit. E vetmja mënyrë mund të jetë duke



Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

përdorur sistemet e Ministrisë së brendshme, por deri në këto momente nuk kemi akses. Ndaj ëhstë e vështirë për ne që të ndajmë këtë kategori dhe tga zerojmë nga tarifat. Pensionistët e vetmuar janë përfitues të lehtësirave fiskale për taksat dhe tarifat e mëdha. Këto ishin në përgjithësi situatat në raport me paketën fiskale.

**Përfaqësues nga shoqata Naftëtari, z. Musa Goxhaj**- përshëndetje! Në qytetin tonë ka shumë lavazho dhe servise. A ka kushte mbi të cilat janë licensuar këto servise dhe lavazho?



**Përfaqësues nga shoqata Naftëtari**
**z. Musa Goxhaj**
**Dëgjesë publike me temë:**
**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

Edhe këto problemet me emigrantët u janë prekur sepse kam një djalë që nuk ka ardhur asnjëherë në Shqipëri dhe nuk merr asnjë shërbim, por përsëri tarifohet. Duhet parë kjo pjesë që emigantët të mos paguajnë.

**Drejtori Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj**– lavazhot marrin licencë nga ana jonë dhe për të gjithë lavazhot që kanë pasur kërkesa ne kemi



**Drejtor,**
**z. Çajup Refitaj**
**Dëgjesë publike me temë:**
**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

dhënë licenca. Serviset nuk i licensojmë ne, por qendra e biznesit i rregjistron. Emigrantët ashtu sikur edhe e theksova nga ana jonë është marrë në shqyrtim sepse kërkesat janë të vazhdueshme. Por kemi shumë problem në përcaktimin e ditëve të tyre të qëndrimit. Gjithashtu ndodh që kryefamiljari të jetë emigrat, por pjesa tjetër e familjes jeton këtu, ndaj duhet bërë një kategorizim më i saktë i këtij grupi.

**Kryetari i fshatit Kuqar, z. Islam Shpata-** përshëndetje! A ekziston mundësia e pagesës së



**Kryetari i fshatit Kuqar**
**z. Islam Shpata**
**Dëgjesë publike me temë:**
**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

këtyre taksave me këste për të gjithë familjet në nevojë?

**Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj-** patjetër që ekziston mundësia e pagesë me këste për të gjitha familjet që e kanë të pamunduar të paguajnë menjëherë. Ne aplikojmë pagesën me këste për këto kategori.



**Drejtor**
**z. Çajup Refitaj**
**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

**Përfaqësues i shoqatës Labëria, z. Fatos Xhufi-** përshëndetje! Unë kam ngritur dhe më herët një problem për taksat e familjeve që janë gjysëm pensionistë dhe mora një përgjigje jo



**Shoqata Labëria**
**z. Fatos Xhufi**

**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**


Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

të plotë. Kur një person është pensioniste dhe një tjetër është i papunë nuk mund të shikohet kjo mundësi për të përfituar nga lehtësirat fiskale?

**Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj**- Ne do ta vlerësojmë këtë kërkesë duke përcaktuar edhe dokumentacionin ligjor që do të na duhet për këtë kategori.



**Përfaqësues i Prefekturës, z. Andi Gjondedaj**- gjithë pjesa e të papunëve dhe kategoritën e këtyre familjeve duhet përfshirë dhe mendoj që është e përfshirë në lehtësirat fiskale. Pra këto lloj kategorish përfshihen në lehtësira fiskale.



**Përfaqësues i Prefekturës**
**z. Andi Gjondedaj**
**Dëgjesë publike me temë:**
**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

**Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj**- janë



**Drejtor**
**z. Çajup Refitaj**
**Dëgjesë publike me temë:**
**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

disa kategori të caktuara që përfshihen, por ka disa raste specifike për të cilat ne do ta shqyrtojmë dhe do të vendosim dhe një bazë dokumentacioni me anë të cilin do vlerësojmë gjendjen.

**Kryetar i fshatit Rrerës, z. Shaban Ruçaj**- Një pjesë e madhe e njerëzve nuk kanë paguar



**Kryetar i fshatit Rrerës**
**z. Shaban Ruçaj**
**Dëgjesë publike me temë:**
**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

taksat dhe për këtë arsye janë të bllokuar ndaj shumë shërbimeve. Ata nuk duan të paguajnë sepse ende nuk janë pajisur me certifikatë pronësie të tokës dhe AMTP. Si do zgjidhen këta njerëz?

**Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj**- Ligji



**Drejtor**
**z. Çajup Refitaj**
**Dëgjesë publike me temë:**
**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

7501 bëri ndarjen e sipërfaqeve të tokës dhe ka shumë fermerë që nuk kanë tërhequr një kopje të AMTP dhe të gjithë ata që nuk e kanë mund ta marrin pranë kadastrës ASHK. Lidhur me qytetarët në nuk pengohemi për taksimin e e tyre pasi ne kemi formularet nr. 6 nga Qarku Fier dhe të dhënat dhe mbi ta bazohemi që taksojmë sipërfaqet. ASHK ka pjesë ligjore që kërkon edhe pajisjen me vërtetimin e taksave në momentin që certifikon.

**Kryetar i fshatit Rusinjë, z. Ajet Bregu-** ne si fshat nuk kemi as formularë Nr. 6 të ndarë. Kemi ardhur kemi pyetur dhe nuk kemi marrë asnjë zgjidhje. Një ditë do vij dhe do kërkohen të gjitha taskat, por ne nuk kemi asnjë dokument.



Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos



**Kryetar i fshatit Rusinjë**
**z. Ajet Bregu**

**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

**Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj-** ne jemi përballur me një situatë me të gjithë banorët e fshatit. Kjo është një pjesë që nuk ndiqet dot nga bashkia pasi kompetencat i ka ASHK për certifikimin e tokave. Gjithsesi kur ky



**Drejtor**
**z. Çajup Refitaj**
**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

proces të kryhet pagesa e taksave do bëhet mbi dokumentat që do të keni.

**Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Artan Velçani-** përshëndetje! Bëhet fjalë për të parashikur



**Anëtar i Këshillit Bashkiak**
**z. Artan Velçani**

**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

buxhetin dhe paketën fiskale dhe me cfarë vura re bashkia ka parashikuar rritjen e disa tarifave. Është bërë ndonjë studim lidhur me rritjen e këtyre tarifave? E dyta sa përqind të buxhetit do të zërë rritja e këtyre tarifave? A ka një studim që përcakton rritjen e tarifave për bizneset?


Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

**Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj-** është bërë një studim për të përcaktuar shkallësn e rritjes së tarifave. Normalisht kjo është një vlerë që i shtohet PBA-së 2026-2028. Duke qënë se kjo lidhet me kostot, nuk është pjesë e investimeve në buxhet, por e përballimit të kstove. Paketa fiskale i kategorizon bizneset sipas xhirove dhe këtu mbështetemi për kategorizimin e bizneseve. Për shkak të natyrave të aktivitetit, do të bëjmë një kategorizim mbi bazën e mbetjeve që gjeneron biznesi. Familje që kanë tokë bujqësore kanë një faturë të lartë dhe kemi vazhduar edhe me marrëveshjet me këste. Po punohet me taksat familjare duke parë edhe komponentët përbërës.



**Drejtor**
**z. Çajup Refitaj**
**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

**Banore e Grizës, znj. Florika Shpërdheja-** përshëndetjeë! Unë kam një ankesë dhe kërkesë pasi e ndjej të padrejtë që dy fëmijët e mirë emigrantë paguajnë tarifa. Kanë paguar nga 2011



**Banore e Grizës**
**znj. Florika Shpërdheja**

**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

e deri më sot. Ata nuk jetojnë fare këtu dhe ne jemi dy pensionsta burrë e grua. Dua të ndalohet kjo lloj pagese për emigrantët. Dua të më kthehet kjo shumë që fëmijët kanë paguar.



Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

**Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj**-Ppër



**Drejtor**
**z. Çajup Refitaj**
**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

sa i përket familjes tuaj, pra ju dhe burri duke qënë se jeni pensionistë ju përjashtoheni nga taksat dhe keni lehtësire, por emigrantët, pra djemtë tuaj nuk përjashtohen nfa tarifat. E theksuam dhe më herët që nuk kemi gjetur një rrugë për të përcaktuar këta emigrantë sa më saktë dhe të ndjekim një praktikë të duhur për ta. Po mundohemi të gjejmë një formë që të përcaktojmë saktë ditët e qëndrimit të tyre. Lidhur me kthimin e shumës e kemi të pamundur pasi nuk e parashikon ligji. Për sa kohë që fëmijët tuaj pjesë e gjendjes sonë civile ata do të tarifohen.

**Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro-** Fëmijët tuaj përderisa janë të ndarë më vete dhe kanë familjet e tyre ata tarifohen më vete. Kështu e parashikon ligji dhe janë të detyruar që të paguajnë deri sa ne të gjejmë një formë dhe një mekanizëm për të përcaktuar qartë qëndrimin e emigrantëve në Shqipëri.



**Kryetar i bashkisë Patos**
**z. Fation Duro**
**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**


Adresa: Lagjja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

**Përfaqësues i shoqatës Labëria, z. Fatos Xhufi-** unë kisha dhe një kërkesë për buxhetin e vitit të ardhshëm. Fillimisht shumë faleminderit që kemi punuar aq shumë te Përroi Çam. Ka filluar edhe projekti te Vreshti ku unë banoj dhe kam një kërkesë për zgjerimin e urës.



**Shoqata Labëria**
**z. Fatos Xhufi**

**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

Gjithashtu asfaltimi i rrugës Qerim Gropa duhet ndërhyrë. Kanali i ujërave të zeza të Përroi mendoj të mos e ndryshojmë diametrin e shkarkimit 100 m.

**Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro-** për sa i përket projektit te lagjja juaj ne kemi folur dhe me ujësjellsin për KUZ dhe na thanë për të ndërhyrë në disa pika, por atje janë edhe



**Kryetar i bashkisë Patos**
**z. Fation Duro**
**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

afërsisht edhe 1 km linj e re kanalizimesh që duhen bërë. Fatmirësisht ne kemi mundësi që të ndërhyjmë si bashki, por edhe pjesë që është te Përroi me beton. Në qoftë se do mundemi do ti lidhim dhe me kolektorin e ujërave të zeza. Rruga "Qerim Gropa" dhe "Ali Laze" do fillojnë këtë vit dhe bashkë me disa segmente të tjera të lagjes së re do përfundojnë. Është edhe një rrugë tjetër mes lagjes të vaj guri që del te banesat sociale për të cilën do shikojmë mundësinë për të ndërhyrë. Rruga "Thimi Sinjari" do të jetë me një sens lëvizje dhe do shikojmë mundësinë që të bëjmë edhe një trotuarë. Lagjja "1 Maj" dhe pas Raiffeisen do fillojnë dhe do bëhen. Do ndërhyet dhe në mënyrën e mbledhjes së mbetjeve për çdo familje që do të ketë kosha personal. Do të vazhdojmë edhe me KUZ. Kemi lënë gjysëm Kuqarin që do përfundojë së shpejti.

**Banore e Rusinjës, znj. Dallandyshe Berberaj**– Jam nga Rusinja, jam e sëmurë, burrin e kam invalid dhe ne kemi 200 m rrugë te shtëpia që ka nevojë për shtrim.



**Banore e Rusinjës**
**znj. Dallandyshe Berberaj**

**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

**Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro**- do të verifikojmë këtë problem dhe do ndërhyjmë spas mundësive për ta zgjidhur.



**Kryetar i bashkisë Patos**
**z. Fation Duro**
**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

**Banor i Kuqarit, z. Albert Rrapaj**- Jemi nja 50 familje që nuk kemi rrugë bujqësore andej nga shpati. Aty duhen të paktën dy rrugë makina me çakull. Të paktën disa malore që janë hapur fare duan çakull.



**Banor i Kuqarit**
**z. Albert Rrapaj**
**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

**Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro-** me çakull mund të ndërhyjmë, por me rërë bituminoze nuk ndërhyjmë dot për momentin.



**Kryetar i bashkisë Patos**
**z. Fation Duro**
**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

**Banor i Dukasit, z. Faslli Lamkaj-** Unë jetoj në Dukas dhe kemi një pjesë rruge nga shkolla "Hekuran Maneku" përballë kalçetos që ikën Dukas. Më herët është hedhur rërë bitumizone aty, por po patët mundësi të ndërhyni dhe ta shtroni.



**Banor i Dukasit**
**z. Faslli Lamkaj**
**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

**Kryetar i fshatit Rrerës, z. Shaban Ruçaj-** edhe rrugët në Rrerës kanë nevojë për ndërhyrje dhe për shtrim.



**Kryetar i fshatit Rrerës**
**z. Shaban Ruçaj**
**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe.rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

**Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro-** Këtë rrugë ne nuk e kemi të parashikuar, por do ta vlerësojmë pasi duhet ta shikojmë nëse është rrugë parcele apo jo dhe nëse mund të ndërhyjmë.



**Kryetar i bashkisë Patos**
**z. Fation Duro**
**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

**Kryetar i Këshillit, z. Armand Ahmetaj-** Nëse nuk keni sugjerime të tjera dhe kërkesa e deklaroj të mbyllur këtë dëgjesë publike. Ju faleminderite!



**Kryetar i Këshillit**
**z. Armand Ahmetaj**
**Dëgjesë publike me temë:**

**"Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026"**
**Shtator 2025**

**Koordinator i Konsultimit Publik**
**Simela Shahinaj**

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**
**Refaela Xeba**